

PERMBAJTJA

1 - HYRJE

2 - PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

3 - PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

4 - PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

5 - NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDIS- MASAT KRYESORE LEHTESUESE

6 - PROGRAMI MONITORIMIT

7. PROGRAMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE MONITORIMI I TREGUESVE TE MJEDISIT

8 - REKOMANDIME

1-HYRJE

1.1.Te pergjithshme

Shoqeria "TELEKOM ALBANIA" sh.a., eshte paisur me "Vendim per VNM paraprake" me Nr. 2715Prot. Date: 15.11.2016, ID 677, Vendimi 57, per ngritjen e nje antene celulare Luginen e Valbones, Margegaj, Bashkia Tropoje, stacioni: "Valbone 1560". Pikerisht ky aplikim behet per nje rruge ndihmese e cila do te sherbeje per te shkuar ne objekt. Ne kete strukture, nuk do te kemi linje prodhimi, por vetem punime ndertimi dhe si rrjedhim, aktiviteti ka ndikim ne mjedis, vetem ne fazen e instalimit. Aplikimi behet per Vleresim Paraprak te Ndikimit ne Mjedis, sipas Ligjit Nr. 10 440, date: 07.07.2011, Shtojca II, Pika 10. Prodhime infrastrukturore. d) Ndertim rrugesh, portesh dhe instalimesh per porte, duke perfshire dhe portet e peshkimit (projekte qe nuk perfshihen ne shtojcën I);

Zona e Valbones eshte tashme nje pike turistike shume e frekuentuar nga turistet sidomos gjate stines se veres. Bazuar ne ankesat e konsumatorëve, u vendos qe te ngrihet nje antene ne kete pike, pas konfirmimit të mbulimit shumë të dobët të deritanishem te sinjalit mobile. Zona e Valbones është shumë e izoluar për shkak të hijeve e pengesave natyrore të cilat pengojnë vizitorët te komunikojne gjate pushimeve. Valët e radios qe vijnë nga stacionet përreth janë shtrembëruar dhe zbutura plotësisht. Duke shqyrtuar këtë izolim është e qartë se zgjidhja e vetme e mbulimit është planifikimi i ngritjes se nje antene te re dhe kjo rruge eshte nje infrastrukture ndihmese e ngritjes se antenes.

Juridikisht ndodhet ne Nj.A. Margegaj, Bashkia Tropoje, Qarku Kukës.

Rruga do te shtrohet ne vendin e quajtur Lugina e Valbones qe eshte shpallur "Park Kombetar", shpallur me VKM Nr. 102, dt: 15.01.1996. Me poshte, interpretimi i AKZM per ngritjen e antenes:

Në përgjigje të kërkesës tuaj Nr. 2393/2, datë 12.07.2016 me lëndë "Kërkesë për marrje me qira të një sipërfaqeje toke në zonën e Valbonës", për ndërtimin dhe instalimin e një stacioni antenash të tipit BTS, për rritjen e cilësisë së shërbimit të telefonisë celulare në zonën e Valbonës, ju sqarojmë sa më poshtë vijon:

Bazuar në të dhënat kadastrale dhe koordinatat paraqitur nga ju, sipërfaqja e kërkuar ndodhet brenda zonës së mbrojtur "Lugina e Valbonës" shpallur Park Kombëtar, me VKM-në Nr. 102, datë 15.01.1996.

Referuar nenit 6, pika 2, shkronja "d", të Ligjit Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (të ndryshuar) në Parqet Kombëtare zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë.

Parku kombëtar "Lugina e Valbonës" ende nuk ka plan menaxhimi dhe zonim të brendshëm.

Kohët e fundit ky park po vizitohet masivisht nga turistë vendas dhe të huaj, pothuaj gjatë gjithë vitit, kjo si rrjedhojë e peisazheve dhe bukurive të rralla natyrore.

Në këtë park, sektori i turizmit është një burim i rëndësishëm ekonomik e në rritje të vazhdueshme për komunitetin, por mungesa e valëve telefonike në këtë zonë ka krijuar pakënaqësi dhe probleme në komunikim. Nisur nga këto arsye, shprehemi dakort për zhvillimin e këtij aktiviteti, por më parë subjekti duhet të pajiset me leje mjedisore dhe të zbatojë me korrektësi të gjitha kushtet dhe kriteret që rrjedhin prej saj.

Ju Faleminderit për bashkëpunimin,



1.2.Procesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Studimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) siguron nje permbljedhje te te dhenave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit te zhvillimit te aktivitetit duke perfshire kushtet fizike atmosferike dhe te burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike te zones. Ne procesin studimor te VNM perdoren informacioni dhe te dhenat ekzistuese dhe te perfituara rishtas mbi kushtet e sheshit, se bashku me standardet dhe normat e zbatueshme per te vleresuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale te fasiliteve te propozuara.

1.3.Metoda e pergatitjes se VNM

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM e permbljedhur. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, sif figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet MM mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit, ne menyren e detajuar ne Shtojcen 3 te Ligjit) dhe veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura te Republikes se Shqiperise apo zona bregdetare te Shqiperise.

Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik te disponueshem, juridik e stafin e subjektit. Me bashkepunimin e subjektit u kryen vizita ne terren nga grupi i punes. AKM eshte autoriteti kompetent ligjor per te kerkuar, analizuar dhe aprovuar dokumentacionin VNM, ku projekti ne vleresim do ti nenshtrohet procedurave te raportit te paraprak te VNM-se.

2 - PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

2.1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne fdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i vecante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara e te promovojë zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 20 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegjel kyc per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimmarrije te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

- Qellimi i pare i drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar te konsiderueshem potencialet ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.
- Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovojte zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efifence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

2.2. Legjislacioni Kombetar

Per me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbeshtetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojte, parashikojte dhe parandaloje ndikimin e ketij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri per VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje per mjedisin ne Shqiperi. Ne menyre te vecante, ligjet e Vleresimit te Ndikimit Mjedisor (VNM) jane zhvilluar dhe kane hyre ne fuqi gjate dekadese se fundit.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM Paraprake dhe VNM e Thelluar.

Aktiviteti ne vleresim, ne baze te klasifikimit te tij si aktivitet me ndikim te vogel ne mjedis, klasifikohet si raport paraprak i VNM.

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te vefante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder ligjet me specifike qe kane lidhje te drejtperdrejte me projektin ne vleresim, mund te permendim:

Ne ligjin Nr. 10 431, date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" theksohet ne kapitullin V (VNM) neni 25 se:

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit.

Ne Ligjin Nr.10 440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" ne kreun II, neni 7 per "Procedurat e vleresimit te ndikimit ne mjedis" thuhet:

Projektet private apo publike, te listuara ne shtojcat I dhe II, bashkelidhur ketij ligji, i nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis, ne perputhje me kerkesat e kreut II te ketij ligji, perpara dhenies se lejes perkatese nga autoriteti pergjegjes per zhvillimin ose jo te projektit.

Procedura e vleresimit te ndikimit ne mjedis perfshin:
procesin paraprak te vleresimit te ndikimit ne mjedis;
procesin e thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Dokumenti baze ku mbeshtetet procesi i VNM-se dhe licencimi, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili, ne varesi te ndikimeve te mundshme te projektit, mund te jete:

raporti paraprak i VNM-se per projektet e shtojces II;
raporti i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis perfshin indentifikimin, sakesimin dhe vleresimin e drejtperdrejte dhe te terthorte te projektit ne mjedisin ku do te zbatohet, si dhe percaktimi i masave per te parandaluar dhe zbutur demtimet ne mjedis qe ne fazen fillestare te tij.

Ky aktiviteti, ne baze te klasifikimit te tij qe ben pjese ne aneksin 2 te ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, klasifikohet si VNM e permbledhur. Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te vecante dhe te rendesishem te mjedisit.

Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

1. Parimet e mbrojtjes se mjedisit
2. Parimi i zhvillimit te qendrueshem
3. Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
4. Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
5. Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit
6. Parimi i qasjes se integruar
7. Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunitimit
8. Parimi "Ndotesi paguan"
9. Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
10. Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si vecmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar. Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujerave
- Mbrojtja e tokes
- Mbrojtja e natyres
- Ndryshimet klimatike

2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor

Legjislacioni mjedisor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te vecante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te permendim:

Ligjin Nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e Mjedisit"

Ligji Nr.10 440, date 7.7. 2011, "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis".

Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"

Ligji Nr. 10 463, date 22.9. 2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"

Vendim Nr. 177, date 6.3.2012 "Per ambalazhet dhe mbetjet e tyre"

Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 "Per planifikimin e territorit"

ligjit nr. 10266 datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9587, date 20.07.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit"

Ligji Nr.10 081, date 23.02.2009 "Per Licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise".

VKM Nr. 686, date 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

Vendim i KM Nr.1189, Date 18.11.2009 "Per Rregullat Dhe Procedurat Per Hartimin Dhe Zbatimin e Programit Kombetar Te Monitorimit Te Mjedisit"

Vendimi i KM Nr. 805, dt 04.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore".

VKM-së nr. 435 datë 12.09.2015 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

Vendimi i KM Nr.247, date 30.04.2014 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin".

Vendim i KM Nr. 123, date 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"

Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"

Vendim i KM Nr. 99, date 18.2.2005 "Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve"

Vendim i KM Nr. 177, date 31.3.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisve ujore pritese"

Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"

Vendim i KM Nr. 16, date 14.01.2012 "Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor"

Vendim Nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen e zonave te mbrojturamonument natyror"

VKM Nr. 575, date 24.06.2015, "Per menaxhimin e mbetjeve inerte"

Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne republiken e shqiperise.

Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:

Ligji Nr. 9672 date 26.10.2000: "Per ratifikimin e konventes se Aarhusit" Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimmarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.

Ligji Nr. 9334 date 16.12.2004: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos" ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).

Ligji Nr. 9424 date 06.10.2005: "Per ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor".

Ligji Nr. 9486 date 06.03.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit" Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.

Ligji Nr. 9548 date 01.06.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve"

2.4. Kuadri institucional

Institucionet pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit

Institucioni kryesor dhe me i rendesishem ne fushen e mjedisit eshte Ministria e Mjedisit. Ne varesi te kesaj ministrie jane edhe Agjencia Kombetare e Mjedisit, Drejtorite Rajonale te Mjedisit, si dhe Drejtorite Rajonale te Menaxhimit te Pyjeve. Ministria e Mjedisit eshte e perbere nga 12 Drejtori Rajonale te Mjedisit te cilat ushtrojne funksion lokal ne rang prefektore dhe Agjencia Kombetare e Mjedisit e cila ka funksion kombetar. Institucione te tjera pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit jane edhe Pushteti vendor, si dhe Ministri te tjera si ajo e Transporteve, e Bujqesise, Ministria e Energjise dhe Industrise, etj, sipas fushes se veprimtarise.

Ministria e Mjedisit (MM)

Ministria e Mjedisit, eshte autoriteti kryesor pergjegjes per menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe hartimin e politikave mjedisore ne nivel kombetar. Ministria e Mjedisit u krijua si organi shteteror i specializuar per mbrojtjen e mjedisit ne Shqiperi. Ajo harton dhe zbaton politiken e qeverise per mbrojtjen e mjedisit, harton projekt-akte ligjore e nen-ligjore ne fuksnion te mbrojties dhe menaxhimit te qendrueshem te mjedisit, bashkerendon aktivitetet e institucioneve te linjes per ceshtje te mjedisit, organizon dhe koordinon punen per monitorimin e mjedisit, pergatit projekt-marreveshjet nderkombetare apo bilaterale per mbrojtjen e mjedisit, pergatit Raportin vjetor "Per Gjendjen e Mjedisit", shqyrton dhe jep aktet e miratimit te lejeve mjedisore per aktivitetet e ndryshme ekonomike, etj.

Ne baze te ligjit per mbrojtjen e mjedisit, neni 67, pergjegjesite kryesore te MMPAU jane:

Si institucion qendror i specializuar per mbrojtjen e mjedisit dhe si mbeshtetese teknike e Ministrit, Ministria kryen edhe keto detyra kryesore:

bashkepunon me institucionet qendrore, me organet e qeverisjes vendore, me publikun dhe organizatat jofitimprures mjedisore e profesionale, per te rritur shkallen e zbatimit te legjislacionit mjedisor; pergatit projektet e marreveshjeve, te protokolleve e programeve te bashkepunimit dy e shume palesh, me shtete, organe dhe organizata nderkombetare per mbrojtjen e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre; studion nevojat e vendit per specialiste per mbrojtjen e mjedisit dhe bashkerendon me Ministrine e Arsimit dhe Shkences per kualifikimin e specializimin e tyre; mbeshtet projekte per pune kerkimore-shkencore, per permiresimin e gjendjes se mjedisit, per futjen e teknologjive ekologjikisht te pastra, per nxitjen e veprimtarive te organizatave jofitimprures mjedisore; ndihmon organet e qeverisjes vendore per mbrojtjen e mjedisit dhe per hartimin e zbatimin e planeve vendore per mjedisin.

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM)

Ne ligjin e ri per mbrojtjen e mjedisit, Nr. 10431, date 09.06.2011, ne Nenin 59 "Organizimi i Agjencise Kombetare te Mjedisit" percaktohet:

Agjencia Kombetare e Mjedisit eshte institucion qendror publik ne varesi te ministrit, qe ushtron juridiksionin e vet ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyres qendrore dhe degeve rajonale ne qarqe, te cilave ketu e me poshte do t'u referohemi si agjencite rajonale te mjedisit.

Agjencia Kombetare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.

Agjencia Kombetare e Mjedisit ka pavaresi ne vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve te saj, te parashikuara ne kete ligj.

Keshilli i Ministrave, ne perputhje me kerkesat e ketij ligji, miraton rregulla te hollesishme per organizimin dhe funksionimin e Agjencise Kombetare te Mjedisit dhe te agjencive rajonale te mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punes, statusin e punonjesve dhe marredheniet e saj me institucione te tjera.

Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, miraton strukturen dhe organiken e Agjencise Kombetare te Mjedisit dhe te agjencive rajonale te mjedisit.

Ndersa ne Nenin 60, te ketij ligji percaktohen funksionet e ketij institucioni. Funksionet e Agjencise Kombetare te Mjedisit:

1. Agjencia Kombetare e Mjedisit eshte autoriteti kompetent per percaktimin e kushteve per lejet perkatese te mjedisit, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, me legjislacionin per lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve te tjera perkatese dhe ka keto funksione:

hartimin e Programit Kombetar per Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes se mjedisit, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;

pergatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore per gjendjen e mjedisit;

kryerjen e sherbimeve te matjes se shkarkimeve ne mjedis me kerkese te ministrise;

keshillimin e organeve vendore per zbatimin e politikave mjedisore;
krijimin dhe menaxhimin e sistemit te informacionit mjedisor;
krijimin dhe menaxhimin e Regjistrimit te Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotsve;
sigurimin e informacionit mjedisor per publikun, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;
sigurimin e informacionit per publikun per procesin e vendimmarrjes per feshajtjet mjedisore, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;
sigurimin e zbatimit te parimit te pergjegjesise mjedisore per fdo operator, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;
menaxhimin e sistemit te dhenave per pyjet.

2. Kjo agjenci kryen edhe funksione te tjera qe i ngarkohen me legjislacion te posacem.

Ne nivel prefektore vepron 12 Drejtori Rajonale te Mjedisit (DRM), te cilat nepermjet ndryshimeve ligjore te muajve te fundit, kalon ne varesi te AKM. DRM-t i kryejne funksionet dhe kompetencat Brenda territorit te nje Qarku te caktuar duke perfshire te gjitha rrethet dhe komunat e bashkites e ketij qarku.

2.5. Metodologjia e Vleresimit


Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik te disponueshem, juridik e stafin e subjektit. Me bashkepunimin e subjektit kerkues. MM eshte autoriteti kompetent ligjor per te kerkuar, analizuar dhe aprovuar dokumentacionin e VNM, ku projekti ne vleresim do ti nenshtrohet procedurave te raportit te permbledhur te VNM-se, si shpjegohet ne menyre te detajuar si me poshte:

VNM-i Permbledhur duhet te permbaje informacionin e me poshtem (neni 8):

- Qellimi i projektit;
- Pershkrim i detajuar i objektivave;
- Te dhena mbi mjedisin ekzistues te zones dhe zonave te aferta me zonen ku do te zbatohet projekti;
- Pershkrim i hollesishem i te gjithe instalimeve qe jane pjese e projektit ose qe do te perdoren gjate zbatimit te tij;
- Pershkrim i veprave inxhinierike qe jane ndertuar ose zgjeruar dhe i punimeve te nevojshme per zbatimin e projektit;
- Ndikimet e mundshme mbi mjedis dhe masat e propozuara per parandalimin ose zbutjen e tyre;
- Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis te projektit;
- Perputhjen e projektit me planin e rregullimit te territorit dhe me planin e zhvillimit ekonomik te zones ku do te zbatohet projekti;
- Permbledhje e konsultimeve me organet e qeverisjes vendore, organizatat jo- fitmprures publike dhe mjedisore dhe te opiniononeve te tyre;
- Masat rehabilituese ne rastet e ndotjes dhe demtimit te mjedisit si dhe kostove te tyre;

3 - PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Objekti do te ngrihet mbi nje truall qe eshte ne administrim te Bashkise Tropoje. Kontrata e huaperdorimit do te lidhet midis paleve, pasi te paiset me lejet perkatese per zhvillimin e aktivitetit. Punimet nuk do te fillojne pa nenshkrimin e kesaj kontrate dhe paralelisht shoqeria do te beje edhe kerkesen per heqje nga fondi pyjor.




***Koordinatat e disa pikave te rruges**

Pika	1	2	3
X	4409280	4409035	4409181
Y	4702920	4703089	4703431

Gjatesia e rruges: 195 ml

Objekti ndodhet ne Luginen e Valbones, Njesia Administrative Margegaj, Bashkia Tropoje. Kjo zone njihet si zone turistike sidomos kohet e fundit eshte shume e frekuentuar nga turistet e huaj. Ketu kemi banesa, te cilat me teper i sherbejne turizmit sezonal. Aktualisht fshati Valbonë ka afro 30 shtëpi, kryesisht kulla të vjetra dy dhe trekatëshe me mure të trashë guri e çati karakteristike alpine me dërrasa druri. Lugina e Valbonës shtrihet në qendër të Alpeve Shqiptare, në Rrethin e Tropojës. Lugina e Valbonës ka statusin e Parkut Kombëtar dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 8.000 hektarësh.



4-PERSHKRIMI I MJEDISIT TE RAJONIT

1.Te pergjithshme


Juridikisht ndodhet ne Nj.A. Margegaj, Bashkia Tropoje, Qarku Kukës.

Rruga shtrihet ne vendin e quajtur Lugina e Valbones qe eshte shpallur ‘‘Park Kombetar’’, shpallur me VKM Nr. 102, dt: 15.01.1996.

Parku Kombëtar ‘‘Lugina e Valbonës’’ ka një sipërfaqe prej 8000 ha dhe konsiderohet si mrekullia e Alpeve Shqiptare. Ndodhet 25-30 km në veri-perëndim të qytetit të Bajram Currit. Shtrihet midis majash të larta e të thepisura të mbuluara me një kolorit fantastik ngjyrash në çdo stinë duke dhënë kështu imazhin e një lugine plot labirinte dhe të papritura.

Lugina e Valbonës është një nga mrekullitë e papërsëritshme të natyrës alpine shqiptare. Kjo luginë ndodhet në pjesën më veriore të vendit në lindje të masivit malor të Alpeve që përfshihet nga rrethi i Tropojës. Lugina e Valbonës nis nga Qafa e Valbonës në perëndim dhe përfundon në luginën e Drinit në jugperëndim, shumë pranë digës së hidrocentralit të Fierzës. Gjatësia e saj nga Qafa e Valbonës deri në lumin Drin është 50.6 kilometra. Lugina e Valbonës është zona turistike më e vizituar në rrethin e Tropojës, madje nga më të vizituarat në Alpet shqiptare pas luginës së Thethit. Kjo zonë me bukuri të rralla është e preferuar jo vetëm nga turistët vendas por edhe nga turistët e huaj, të cilët parapëlqejnë të njihen edhe me zakonet apo traditat e fshatrave më veriorë të vendit.

Klima e luginës është mjaft e freskët dhe i xehti i verës nuk egziston fare. Fshati Valbonë është gati 1000 metra mbi nivelin e detit dhe shtrihet në një zallishte të krijuar prej lumit Valbona. Aktualisht fshati Valbonë ka afro 30 shtëpi, kryesisht kulla të vjetra dy dhe trekatëshe me mure të trashë guri e çati karakteristike alpine me dërrasa druri. Në kullat karakteristike të tërheqin vëmendjen dritaret shumë të vogla dhe frëngjitë e ndërtuara në çdo drejtim për tu mbrojtur. Në qëndër të fshatit ndodhet një lokal që shërben në natyrë kryesisht, mish të pjekur në hell dhe meze e bylmet të zonës. Pranë lokalit është në ndërtim e sipër një basen i vogël për rritjen e troftës pikaloshë të Valbonës. Në Valbonë nuk ka hotel të mirfilltë, por disa shtëpi-kulla karakteristike janë përshtatur sipas traditës në hotele për turistët. Çmimet e fjetjes dhe ushqimit janë të arsyeshme. Nëpërmjet bllokut të lartë malor të Jezercës në veri, Zhaborreve dhe Grykave të Hapta në Jug, formohet një govatë tipike akullnajore. Në shpatet e thepisura të maleve të Kollatës e Rrethit të Bardhë shikon borë të përherëshme dhe ngjitja në to, do të ishte një sfidë për çdo alpinist profesionist. Ujëvara e Rragamit që ndodhet pranë fshatit me të njëjtin emër, sipër Valbonës, është një tjetër mrekulli e natyrës alpine që nuk duhet lënë pa vizituar. Valbona gjatë 4-5 muajëve të dimrit është krejtësisht e izoluar nga bora kështu që në këtë kohë është e pamundur të vizitohet.



Veçoritë litologjike

Gjeologjikisht rrethi i Tropojës, ku bën pjesë dhe qyteti i Bajram Curri, shtrihet në kontaktin e përplasjeve të 3 zonave tektonike: të zonës së Mirditës, zonës së Alpeve dhe të zonës së Cuklit dhe me thyerjen e madhe tektonike Shkodër–Pejë.

Formacionet gjeologjike që ndërtojnë truallin e kësaj zone janë të larmishme dhe të shumëllojshme si sedimentarë, magmatikë, metamorfikë të llojeve të ndryshme, me të cilat lidhen pasuritë e shumta minerale nëntokësore të cilat ndihmojnë sadopak në zhvillimin social – ekonomik të të gjithë rrethit. Me shkëmbinj të magmatikë të cilët përfaqësohen nga peridotide që kanë ngjyrë jeshile lidhet me mineralin e kromit. Të dy llojet e shkëmbinjëve favorizojnë që rrethi i Tropojës të zhvillojë industrinë e nxjerrjes së mineraleve të kromit. Shkëmbinj të magmatik dhe gëlqerorë janë më të përhapur në të gjithë territorin e qytetit të Bajram Currit.

Veçoritë morfologjike

Qyteti i Bajram Currit shtrihet në gropën e Tropojës, e cila është gropa me shtrirje më të madhe në veri të Shqipërisë. Ajo ka një relief relativisht të butë dhe lartësi që variojnë nga 200–700–800 m mbi nivelin e detit^[5]. Formimi i kësaj grope lidhet me përplasjen e tri zonave tektonike (Mirditë, Alpe dhe Cukal) dhe me thyerjen e madhe tektonike Shkodër–Pejë. Ajo përbën një graben të ri, i cili për një kohë të gjatë ka qënë i zënë nga një liqen, prania e të cilit dëshmohet nga qymyret dhe dhe depozitimet argjilore. Në këtë liqen derdhej edhe Valbona me degët e saj. Pjesa më e madhe e liqenit është në Cërnice, ku edhe trashësia e argjilit është më e madhe. Tharja e liqenit lidhet me erozionin regresiv të ndonjë dege të Drinit, që pasi thau liqenin, tërhoqi me vete rrjedhjet ujore duke formuar kështu rrjedhjen ujore të lumit të Valbonës. Në këtë proces kanë ndikuar edhe lëvizjet ngritëse, që vazhdojnë edhe sot. Për pasojë Valbona dhe degët e saj kanë coptuar sipërfaqen e kësaj grope. Lëvizjet ngritëse janë zhvilluar të ndërthurura me periudha qetësie relative, që është shoqëruar më formimin e 2-3 nivele taracash erozive-akumuluese që në dalje të Valbonës dhe Gashit në gropën e Tropojës, ndërthuren me kodrinat moranike^[6]. Copëtimi horizontal i relievit të saj është i madh sidomos në shpatin perëndimor. Vlerat më të vogla takohen në sipërfaqet e pakta të sheshta të kësaj grope. Energjia e relievit merr vlera që lëkunden nga 50–100 m/km² në pjesën fundore, në mbi 300 m/km² në pjesën veriore të saj. Gropa e Tropojës është asimetrike: shpati perëndimor i përbërë nga flishi në pjesën e poshtme, është më i lartë dhe më i copëtuar se ai lindor, verior dhe jugor shumë të thepisuara kryesisht gëlqerorë^[7]. Qyteti i Bajram Currit rrethohet nga maja e kreshta të larta dhe


lugina të thella lumore. Këtu mund të përmendim kurrizin **Toplanë-Bosh dhe Maja e Hekurave** në pjesën perëndimore, lugina e **Nikaj-Currajt** në lartësi nga 140 m deri në 1200–1300 m, **lugina e Valbones** në veri, etj.

Veçoritë e klimes

Bajram Curri bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare paramalore dhe malore me ndikim kontinental. Klima karakterizohet nga një dimër i ftohtë dhe verë e freskët dhe e thatë. Kjo lidhet me ndikimin e fuqishëm të erërave të forta që vijnë nëpërmjet qafës së Morinës dhe të Pejës nga Rrafshi i Dukagjinit. Temperatura mesatare e janarit arrin në rreth 1 °C, ndërsa ajo e korrikut në 22 °C^[8]. Temperatura mesatare vjetore është rreth 11.9 °C, ndërsa temperatura minimale e regjistruar deri tani është -22 °C. Reshjet bien në formë shiu dhe në formë bore. Reshjet janë të shpërndara në mënyrë të çrregullt, ku bien rreth 1450mm/vit. Sasia e reshjeve mesatare arrin në 1700mm. Ato në formë bore në disa zona të veçanta shkojnë deri në 2-3m si rasti i vitit 1985. Bora zgjat nga fund i vjeshtës në interval deri nga fillimi i pranverës. Po t'i analizojmë këto elemente klimatike del se kjo shumëllojshmëri klimash e favorizon zhvillimin social-ekonomik të zonës.


Temperaturat maksimale të ajrit në gradë celcius në qytetin e Bajram Currit sipas muajve.

Muaji	Jana r	Shkur t	Mar s	Prill	Maj	Qesho r	Korri k	Gush t	Shtato r	Teto r	Nënto r	Dhjeta r	vjetor e
B.Curri	0,3	2,4	6,1	11,8	16,1	20	22,2	22,4	18,2	12,4	7,8	3,1	11,8



- Temperaturat minimale të ajrit në gradë celcius në qytetin e Bajram Currit sipas muajve


Muaji	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	V
B.Curri	-18,7	-17,9	-13,0	-2,8	0,3	4	6,9	6,4	3,3	-2,0	-14,8	-16,4	-18,7



Temperatura minimale e ajrit

- Sasia mesatare mujore dhe vjetore e reshjeve në mm në qytetin e Bajram Currit sipas muajve.

Muaji	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	Vjetore
B.Currit	252	180	120	116	114	78	72	51	93	206	352	212	1846



Sasia mesatare e reshjeve (mm)

Veçoritë hidrografike [\[redakto | redakto tekstin burimor\]](#)

Qyteti i Bajram Currit bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të Valbonës, i cili është lumi më i gjatë i Alpeve shqiptare dhe ushqimi kryesor i saj është shkrija e borës. Pavarësisht se lumi i Valbonës nuk kalon në territorin administrativ të qytetit të Bajram Currit atë e përshkojnë 3 degët e tij të rëndësishme që janë : përroi i Shudenicës, përroi i Janës si dhe një degëzim i Janës si dhe një degëzim i Shudenicës. Gjithashtu janë të pranishme dhe disa burime ujore sipërfaqësore, të cilat shërbejnë dhe për furnizimin me ujë të pijshëm ashtu dhe për vaditje në disa zona në periferi të qytetit.

Veçoritë e tokave

Përsa i përket llojit të tokave ato janë të shumëllojshme të kafejta dhe të hirta kafe si dhe të murme pyjore dhe aluvionale më në veri të qytetit, të cilat i përkasin luginës së Valbonës. Në tokat e kafenjta kultivohen bimët e arave, drufutoret, perimet, të cilat shtrihen në pjesën periferike të qytetit. Shkalla e degradimit në zona të veçanta paraqitet e lartë sepse u hapen toka në pjerrësi deri në 10°, gjë që shkakton degradim të tokës të shkaktuar nga faktori antropogjen dhe me pas nga ai natyror. Pjesa më e madhe e sipërfaqes është e zënë nga ndërtimet dhe vetëm në pjesën periferike vihen re kultivimi i kulturave drufutore ashtu dhe të tokave bujqësore.

Veçoritë e biodiversitetit

Diferencimet e mëdha mbi nivelin e detit, në mes të zonës fushore 250m me asaj malore mbi 2000m, majave shumë të larta, luginave shumë të thella, ekspozimit të shpateve ndaj rrezatimit diellor, përbërjes së shkëmbinjve, burimeve të shumta ujore dhe mikroklimave që krijohen krijojnë kushte ideale për shumëllojshmërinë e specieve bimore. Për vlerat e larta që ka biodiversiteti një përqindje e konsiderueshme e specieve bimore janë bimë endemike. Qyteti i Bajram Currit ndodhet në brezin e pyllit të lisit. Në pjesën veriore të qytetit ndosdhet "Pylli i Gështenjës" me një sipërfaqe 2600 ha. Janë të

pranishme kati i dushqeve dhe pjesërisht i ahut më në periferi. Një e vecantë për këtë zonë është se një pjesë e banorëve që jetojnë në qytet, bejnë një jetë të dyfishtë në mes dy botëve: ajo nga qershori në shtator dalin në bjeshkë për mbledhjen e bimëve mjekësore që sigurojnë një pjesë të të ardhurave dhe pjesa tjetër në zonën fushore (qytet) në periudhën shtator-maj. Fauna përfaqësohet nga disa lloje kafshësh dhe shpendësh të egër që jetojnë në brendësi të pyllit dhe të masiveve të gështenjave në periferi të zonës së qytetit.

Vlerësimi i kushteve natyrore (resurseve natyrore). Pozita gjeografike si dhe kushtet natyrore në të cilat ndodhet qyteti i Bajram Currit ofrojnë kushte të mira të zhvillimit social dhe ekonomik të zonës. Kushtet natyrore në të cilat ndodhet qyteti, vendosja në një relief relativisht të rrafshët, me një klimë më të zbutur në krahasim me komunat e tjera përreth, rrjeti i pasur hidrik si dhe puna e tokave të kafenjta dhe të hirta kafe, ofrojnë mundësi zhvillimi si të sektorëve të shërbimeve ashtu dhe të sektorit të bujqësisë në zonën periferike të qytetit. Gjithashtu prania e një sipërfaqe të konsiderueshme të pyllit të gështenjës ofron mundësi të gjenerimit të të ardhurave nëpërmjet tregtimit.

Demografia

Historiku i popullimit

Qyteti i Bajram Currit ka një popullim të hershëm dhe të vazhdueshëm që nga lashtësia e deri në ditët e sotme. Kjo vazhdimësi e popullimit dhe vendbanimeve paraqitet nëpërmjet gjetjeve arkeologjike. Sipas të dhënave arkeologjike rezulton se Tropoja (Bajram Curri) është banuar që në periudhën e neolitit, e deri në ditët e sotme. Gjatë shekullit të parë të erës sonë vendbanimi i Tropojës përshkruhet në shkrimet e vjetra të udhëtarëve të cilët përmendin Valbonën^[9]. Kjo zonë ka qenë pjesë e territoreve Dardane. Gjurmët arkeologjike që paraqiten në qyteza antike dhe kala, vërtetojnë më së miri vazhdimësinë e jetës në këtë zonë. Këtu mund të përmendim qytetën antike të Shoshanit, me një sipërfaqe rreth 4 ha, e cila gjendet në hyrje të luginës së Valbonës, shumë afër qytetit të Bajram Currit. Gjithashtu vërtetime të tjera të vazhdimësisë së jetës vijnë nëpërmjet egzistencës së kalave të shumta (e Resujës, Dushajt, Lekbibajt, Cërnica, Geg Hysenit, Shoshanit etj); gurëve të gdhendur dhe shkrimeve që i përkasin shek. I të erës sonë; pllaka varri, etj; Objektet e zbuluara rastësisht në Tropojë flasin për nivele të larta jetese e kulture. Në periudhën e Mesjetës princi i zonës ka qenë Pjetër Spani, që me katër djemtë e tij ka marrë pjesë në Besëlidhjen e Lezhës në vitin 1443. Në këtë periudhë territori i sotëm i rrethit të Tropojës, së bashku me Junikun dhe Gjakovën emërtohej "ALTIN-ILI" që në "gjuhën komane" do të thotë, krahinë e artë e pasurisë dhe bollëkut^[10]. Popullsia e Bajram Currit është një popullsi autoktone aq edhe e ardhur nga Kosova dhe rrethet fqinje ashtu dhe nga komunat e rrethit të Tropojës.

Veçoritë e popullsisë

Popullsia e qytetit të Bajram Currit ka pësuar ndryshime gjatë periudhave të ndryshme kohore. Gjatë periudhës së sistemit socialist, popullsia ishte e lartë e cila lidhet me politikën e asaj kohe për shtimin e numrit të lindjeve e cila ndikonte në mënyrë direkte dhe në shtimin e numrit të popullsisë. Pas vitit 1990, ashtu si të gjithë qytetet veriore dhe ky qytet i vogël u prek nga migrimi i popullsisë drejt zonave të tjera më të zhvilluara të vendit dhe sidomos emigrimi jashtë kufijëve. Por sërish popullsia e qytetit të Bajram Currit u zëvendësua nga popullsia e ardhur nga zonat rurale të rrethit të Tropojës. Kështu në vitin 2001 popullsia e Bajram Currit ishte rreth 6561 banorë, ndërsa në vitin 2008 ajo u rrit në 8466 banorë, ndërsa aktualisht ka 8192 banorë^[11]. Siç vihet re qyteti i Bajram Currit nga viti 2000 e në vazhdim ka pësuar luhatje të numrit të popullsisë. Kjo lidhet me zhvendosjen e popullsisë nga zonat rurale drejt qytetit të Bajram Currit dhe largimin e popullsisë drejt zonave të tjera urbane dhe uljen e numrit të lindjeve. Dendësia e popullsisë së qytetit të Bajram Currit është rreth 27 banorë/km²^[12].

Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Nr.i popullsisë	8738	8505	8466	8157	8159	8336	8192

Lëvizjet mekanike të popullsisë kanë qenë gjithmonë të pranishme në rrethin e Tropojës. Gjatë periudhës së sistemit socialist 45-90 në këtë zonë u sollën punëtorë të shumtë dhe specialist nga rrethe të tjera që kanë jetuar në qytetin e Bajram Currit. Gjithashtu ka pasur edhe pakica kombëtare, si sllavë, që kanë ardhur për arsye të ndryshme dhe me mbylljen e kufijve pas viteve 1945 kjo popullsi që e detyruar të qëndrojë në këtë zonë. Pas vitit 1991 kjo popullsi është larguar për në vendbanime të tjera të Shqipërisë ose jashtë saj. Lëvizjet masive migruese të popullsisë së Bajram Currit janë theksuar pas 1991. Faktorët kryesorë që kanë çuar në migrimin e popullsisë mbyllja e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe rritja e nivelit të papunësisë, infrastruktura e dobët e transportit dhe komunikacionit, kushtet e vështira natyrore, etj. Gjithashtu një faktor shtesë i migrimit të popullsisë në Bajram Curri dhe në rrethin e Tropojës në përgjithësi, ka qenë dhe kriza e Kosovës më 1999, e cila ka bërë që një pjesë e popullsisë të largohet për shkak të afërsisë kufitare me Kosovën dhe rrezikut që i kanosej. Të larguarit kryesisht janë vendosur në qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, etj. Gjithashtu me ndërtimin e rrugës nga qyteti i Bajram Currit për në Kosovë, banorët e qytetit tregtinë kryesore e bëjnë atje dhe një pjesë të vogël në Tiranë. Të ardhurit janë me origjinë nga zona të ndryshme të rrethit e jashtë tij. Format e migrimit të popullsisë kanë qenë të ndryshme si migrimi i brendshëm dhe migrimi i jashtëm.

Migrimi i brendshëm i popullsisë është bërë nga një zonë në tjetrën, kryesisht nga fshatrat e thella drejt qytetit; nga qyteti drejt zonave urbane si Tirana, Durrësi, Fushë-Kruja, etj. Ndërsa migrimi i jashtëm ka qenë kryesisht i drejtuar nga vendet fqinje si Greqia, Italia, Kosova, Mali i Zi, por edhe drejt Francës, Gjermanisë, Zvicrës, Britanisë së Madhe,

Zhvillimi ekonomik

Pozita gjeografike si dhe kushtet natyrore në të cilat ndodhet qyteti i Bajram Currit nuk i ofron mundësi të mëdha zhvillimi. Sektori më i përhapur në qytetet është sektori i tregëtisë, i cili përfaqësohet nga tregtia dhe shërbimi. Në këtë kapitull janë trajtuar çështje të cilat lidhen me treguesit e zhvillimit ekonomik të qytetit të Bajram Currit (HDI, GDP, papunësia, niveli i varfërisë, etj) si dhe mundësitë që ekzistojnë për angazhimin e popullsisë dhe punësimin e saj.

Ndikimi i kushteve natyrore dhe humane në zhvillimin ekonomik

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore në të cilat ndodhet qyteti i Bajram Currit janë sa favorizuese aq edhe penguese në zhvillimin ekonomik të tij. Pozita gjeografike në veri të Shqipërisë, mundësia e pakët e komunikimit me botën e jashtme (përveç Kosovës) e bëjnë të vështirë komunikimin dhe lëvizjen e popullsisë si dhe mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu kushtet natyrore të saj bëhen shpesh penguese për të mirat dhe shërbimet. Duke qenë se qyteti i Bajram Currit rrethohet nga një terren malor dhe me një klimë të ashpër, gjatë stinës së dimrit ku shndërrohet në një vend të izoluar nga bora. Kjo ndikon dhe në mungesën e energjisë elektrike dhe ndërprerjes së sinjaleve telefonike, internetit, etj. Të gjitha këto ndikojnë në zhvillimin ekonomik të qytetit. Por nga ana tjetër rrjeti i pasur hidrografik, biodiversitetit të lartë si dhe bukurive natyrore që gjenden në rrethin e Tropojës ofrojnë mundësi të zhvillimit ekonomik. Shtimi i lëvizjeve turistike dhe investimet e realizuara, projektet e për ndërtimin e hidrocentraleve apo burimet minerale të cilat gjenden në rrethin e Tropojës ofrojnë mundësi të mira për

shtimin e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve që ofrohen nga qendra kryesore administrative të rrethit të Tropojës, Bajram Currit.

Treguesit e zhvillimit ekonomik

Indikatorët e zhvillimit ekonomik të një vendi janë HDI (Human Development Index) ose Indeksi i Zhvillimit Njerëzor, GDP (Produkti i Brendshëm Bruto), GDP/për frymë, niveli i punësimit, rritja ekonomike, niveli i varfërisë, etj. Përsa i përket Indeksit të Zhvillimit Njerëzor, rajoni Verior dhe Verilindor i Shqipërisë ka indeksin më të ulët të zhvillimit me rreth 0.733^[15]. Indeksi i përgjithshëm i qarkut të Kukësit është 0.726, rajoni më i varfër në Shqipëri^[15]. Në kuadër të tij qyteti i Bajram Currit paraqitet si një vend me të ardhura të pakta, ku indeksi i zhvillimit është 0.737^[16]. Kjo tregon se dhe niveli i varfërisë është i lartë, gjë e cila lidhet me mundësitë e kufizuara të punësimit. Gjithashtu niveli i varfërisë në qytetin e Bajram Currit lidhet dhe me faktorë të tjerë, ku duhet përmendur edhe humbjet financiare që patën një numër i konsiderueshëm familjesh nga firmat piramidale në vitin 1997. Prodhimi Kombëtar Bruto (GDP), ashtu si dhe Indeksi i Zhvillimit Human, është në nivele të ulëta dhe bazuar në këto dy tregues qarku i Kukësit mbetet sërish qarku më i varfër në Shqipëri. Në rastin e qytetit të Bajram Currit GDP-ja është 0.479 USD për frymë. Ndërsa në nivele qarku ajo është 1.564 USD për frymë, në të njejtën kohë që Shqipëria e ka GDP për frymë 3.569 USD/frymë^[17]. Kjo tregon dhe varfërinë e popullsisë, e cila jeton nën 1 \$ për frymë. Për këtë arsyeje kësaj zone i duhet dhënë mundësi që të shmanget niveli i ulët i varfërisë. Papunësia është një tjetër problem i mprehtë që del në pah në qytetin e Bajram Currit. Shumica e popullsisë rezulton e papunë, gjë e cila lidhet dhe me zhvendosjen e popullsisë nga zonat rurale drejt qytetit. Nivelin më të lartë të papunësisë e vëmë re tek femrat. Kjo lidhet dhe me nivelin e ulët të arsimit të femrave edhe pse vitet e fundit ka prespektivë të rritjes së nivelit të arsimit. Shumica e femrave, të cilat rezultojnë të punësuar, janë përfshirë kryesisht në administratën publike, arsim, dyqane private, etj. Në qytetin e Bajram Currit, gratë përbëjnë rreth 50 % të papunëve. Popullsia aktive që është në gjendje për të punuar në qytetin e Bajram Currit është rreth 4472 persona^[18]. Nga këto rreth 45% e tyre rezultojnë të punësuar, 35% e tyre kanë qënë në punë dhe rezultojnë të papunë, pasi kërkojnë një punë të re, ndërsa rreth 15% kërkojnë punë pëe herë të parë dhe 5% e kësaj popullsie është inaktive për të punuar^[19]. Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se qyteti i Bajram Currit ka një shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik në rang qarku dhe kombëtar. Kjo lidhet dhe me nivelin e lartë të varfërisë së popullsisë, ku rreth 20.28% e popullsisë është e varfër. Në qytetin e Bajram Currit 673 familje trajtohen me ndihmë ekonomike nga bashkia. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit ekonomik të rrethit të Tropojës janë hartuar disa plane për nxjerrjen e popullsisë nga varfëria. Disa nga synimet e strategjisë së zhvillimit për qytetin e Bajram Currit mund të përmendim :

- Përgjysmim deri në vitin 2015 të njerëzve me të ardhura më pak se 1USD në ditë ;
- Rritja dhe zhvillimi intensiv i prodhimit bujqësor të orientuar nga tregu dhe aktivitetet e përpunimit të tyre ;
- Promovimi i zhvillimit industrial i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme i industrisë së përpunimit dhe i infrastrukturës së tregjeve;
- Zhvillimi i infrastrukturës turistike nëpërmjet zhvillimit të rrugëve, furnizimit me ujë të pijshëm, sistemim të ujrave të zeza, furnizimit me energji elektrike dhe në fokus përgjysmimi deri në 2015 të njerëzve pa akses të qëndrueshëm ;
- Rritja e numrit të pikave të grumbullimit për shitje të produktit bujqësor.

Sektorët e ekonomisë

Gjatë periudhës 1945-1990, ashtu si në të gjithë Shqipërinë dhe në rrethin e Tropojës u bë kolektivizimi i tokave dhe u shtetëzuan të gjitha ndërmarrjet ekonomike. Gjatë kësaj periudhe popullsia e qytetit të

Bajram Currit ishte e punësuar në aktivitete ekonomike terciare (tregti, shërbime, administratë, etj) si dhe një pjesë e saj në aktivitete bujqësore në zonat periferike të qytetit. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i banorëve u angazhua dhe në industrinë e nxjerrjes së mineraleve, miniera e Kamit, si dhe ndërtimin e hidrocentralit të Fierzës. Por gjatë viteve të fundit të sistemit socialist, gjendja ekonomike e popullsisë u rëndua së tepërmi. Pas viteve 1990, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë u largua. Në të gjitha ndërmarrjet filloi procesi i privatizimit dhe një përqindje e popullsisë rezultuan të papunë. Kjo papunësi solli efekte negative në pakësim të të ardhurave. Një pjesë e kësaj popullsie të papunë iu përkushtua sektorit të tregtisë që me të ardhurat që mernte të siguronte jetesën. Vitet e fundit ka një interes të veçantë përsa i përket zhvillimit të turizmit, gjë e cila ndikon në rritjen e aktiviteteve ekonomike të qytetit të Bajram Currit. Sot në qytetin e Bajram Currit mbizotëron sektori i tretë i ekonomisë, tregtia dhe shërbimet, të cilat funksionojnë në sektorin privat. Sot qyteti i Bajram Currit i siguron të ardhurat bazë të ekonomisë nga tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale, tregtia e veshjeve, tregtia e mjeteve të bujqësisë, etj. Në qytetin e Bajram Currit ndodhen rreth 140 biznese private si supermarketet, dyqane, lokale, bare dhe restorante, të cilat sigurojnë të ardhura të kënaqshme për popullsinë që merret me këto aktivitete^[12]. Gjithashtu në qytetin e Bajram Currit gjenden dhe dy pika të grumbullimit të gështenjës dhe boronicës. Një pjesë e popullsisë që jeton në zonat periferike të qytetit kultivojnë dhe drufrutorë si kumbulla, dardha, rrush, etj. Këto përdoren përgjithësisht për vetëkonsum, por ka raste të viteve me prodhim të madh që tregtohen në dyqanet ushqimore në qytet. Në pjesën veriore të qytetit gjendet masivi i gështenjës i cili zë një sipërfaqe prej 2600 ha, dhe sjell të ardhura të konsiderueshme për popullsinë e zonës. Industria në qytetin e Bajram Currit përfaqësohet nga industria e përpunimit të drurit dhe të mobiljeve. Në qytetin e Bajram Currit janë ngritur 5 zdruktari, të cilat përpunojnë drurin pishë e ahu që e sigurojnë nga komunat përreth. Gjithashtu janë ngritur 3 qendra të rodhimit të mobiljeve, si dhe 3 qendra të prodhimit të dyerve dhe dritareve të duraluminit^[12]. Industria e zhvillimit të turizmit në rrethin e Tropojës ndikon edhe në zhvillimin ekonomik të qytetit të Bajram Currit. Turistët që vijnë për të vizituar bukuritë e Tropojës ndalojnë në qytetin e Bajram Currit. Objektet e vizitueshme në qytet janë kryesisht historike si Muzeu Historik, pallati i Kulturës, etj. Një pjesë e konsiderueshme e turistëve qëndrojnë të paktën 1 natë në Bajram Curri, për të më tej rrugët drejt pikave turistike. Kjo ka bërë që qyteti i Bajram Currit të ngrejë infrastrukturën e nevojshme për turistët siç janë bare, restorante, hotele, etj.

Infrastruktura

infrastruktura arsimore, infrastruktura shëndetësore, furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë të pishëm, shërbimet postare dhe bankare, infrastruktura rrugore dhe gjendja aktuale e saj etj.

Infrastruktura arsimore

Qyteti i Bajram Currit, si qendra kryesore administrative e rrethit, gjithmonë ka patur prioritet në zhvillimin e arsimit në krahasim me komunat e tjera. Nga qyteti i Bajram Currit kanë dalë personalitete të shquar shqiptar si: Ali Ibra, Sali Berisha, etj. Por fenomenet negative me të cilin është shoqëruar qyteti i Bajram Currit, është ajo që quhet Brain Drain, ose migrimi i trurit. Shumica e kësaj popullsie të arsimuar kanë pasur tendencën për të larguar nga qyteti i Bajram Currit, duke investuar në vende të tjera si brenda Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Sot infrastruktura arsimore e Bajram Currit përfaqësohet vetëm nga arsimit publik. Ai është i përfaqësuar nga arsimit parashkollor (1 çerdhe dhe 2 kopshte). Arsimit 9-vjeçar si dhe arsimit i mesëm. Në qytetin e Bajram Currit ka një çerdhe dhe 2 kopshte, të cilët kanë rreth 278 fëmijë^[20]. Arsimit 9-vjeçar përfaqësohet nga tre shkolla 9-vjeçare, shkolla "Besëlidhja e Malësisë", shkolla "Konferenca e Bujanit" dhe shkolla "Ali Podrimja", të cilat kanë rreth 1850^[21] nxënës dhe një staf pedagogjik prej 110^[12] mësuesish. Ndërsa arsimit i mesëm përfaqësohet vetëm nga një shkollë e mesme "Asim Vokshi". Shkolla "Besëlidhja e Malësisë" ka gjithsej një numër prej 903 nxënësish, dhe një staf prej 52 mësuesish.

Shkolla "Konferenca e Bujanit" ka gjithsej një numër prej 457 nxënësish dhe një staf prej 31 mësuesish. Përveç mësimit paradite, në këto shkolla disa klasa vazhdojnë mësimin dhe pasdite. Shkolla 9-vjeçare "Ali Podrimja" është një shkollë e re e cila ka vazhduar te funksionojë që me datën 19.11.2012. Ajo ka gjithsej 489 nxënës me një staf prej 25^[22] mësuesish. Gjithsej ka 21 klasa ku 10 janë të ciklit të ulët me nga 2 paralele dhe 11 klasa janë të ciklit të lartë^[22]. Në këtë shkollë funksionojnë 4 laboratore, kimie, fizike, biologjie dhe informatike, gjithashtu ka një palestër dhe një bibliotekë. Ajo është një shkollë e standartve bashkëhore. Shkolla e mesme "Asim Vokshi" është e vetmja shkollë e mesme publike në Bajram Curri. Ajo ka rreth 920 nxënës që vazhdojnë mësimin ditën, mbi 800 nxënës vazhdojnë mësimet me sisteme part-time, dhe këtë dhe këtë vit është hapur një klasë e re e përbërë nga 40 nxënës që quhet klasë natë. Ka një staf të përbërë nga 42^[22] mësuesish. Numri i lartë i nxënësve në shkollën e mesme lidhet me faktin se një pjesë e nxënësve të fshatrave preferojnë që të kryejnë studimet e arsimit të mesëm në qytetin e Bajram Currit. Rreth 99% e mësuesve që japin mësim në arsimin e mesëm janë me arsim të lartë iniversitar, ndërsa në shkollat 9-vjeçare rreth 70% e mësuesve janë me arsim të lartë, ndërsa pjesa tjetër kanë arsim të mesëm profesional. Niveli i alfabetizimit në qytetin e Bajram Currit është në shifra shumë të vogla, për të mos thënë i papërfillshëm.

Infrastruktura e qytetit të Bajram Currit ka një ndikim pozitiv në të gjithë komunikimin dhe anëtarët e familjes. Furnizimi i rregullt me energji elektrike, uji i pishëm i rrjedhshëm, rrugë më shërbim urban të rregullt janë faktorë lehtësues për banorët. Në qytetin e Bajram Currit, gjendja e përgjithshme e infrastrukturës është funksionale, por shumë e amortizuar dhe që duhen rikonstruktuar.

Furnizimi me ujë të pishëm Rrethi i Tropojës ka burime të shumta ujore mbi dhe nëntokësore. Këto burime janë të mjaftueshme për popullsinë në rast se funksionojnë me efikasitet dhe nuk ka ndërhyrje të paligjshme në rrjet. Ndonëse burimet janë të shumta e rëndësishme problem qëndron në tubacionet dhe sigurimin e pastërtisë së tij deri në çesmat e familjeve. Për këtë janë përcaktuar një sërë ndërkyerjesh si: rritja e investimeve për përmisimin e cilësisë së ujit: rehabilitimin i rritjeve të kanalizimeve nëpërmjet menazhimit të mirë të shërbimeve; rregullimi i tarifave; matja e saktë e konsumit të ujit; zvogëlimi i lidhjeve të paligjshme dhe nxitja e pagesave; kalimi i pronësisë së infrastrukturës së ujësjes dhe kanalizimeve nga qeveria qendrore në atë lokale (të bashkise) etj. Problemi që egzistonte në qytetin e Bajram Currit ishte ndërprerja e furnizimit të ujit gjatë ditës (vetëm 9 orë në ditë), por me projekte të financuara nga bashkia për rikonstruksionin e kanalizimeve të ujërave të bardha ky problem po gjen zgjidhje. Aktualisht është bërë lidhja ujësjesin e Qarkut të Dunishës, i cili ka përfunduar në dy lagje të qytetit kanë furnizuar 24 orë më ujë të pishëm. Rreth 90% e familjeve të qytetit kanë sistem uji brenda familjes, 8% e kanë sistemin e ujit jashtë shtëpisë dhe vetëm 2% furnizohet me ujë depozite^[24]. Por përfundimin e projektit të ujësjesit dhe ky problem do të marrë fund. Problemi kryesor për një pjesë të qytetit të Bajram Currit mbetet amortizimi i tubacioneve për shkak të së cilës ka pasur raste dhe të përzierjes së tyre me ujrë të zeza, por me projektet që po realizohen ky problem nuk do ndodhë më.

Furnizimi me energji elektrike dhe sistemi i ngrohjes thuhet se është një problem i zgjidhur në qytetin e Bajram Currit. Në përgjithësi nuk ka ndërprerje të saj, duke përjashtuar rastet e remonteve, defekteve apo stugive të dimrit. Problemi kryesor në furnizimin me energji elektrike mbetet amortizimi i shtyllave të tencionit transformatorëve, kabllëve, izolatorëve etj. Këto bëhen shpesh dhe burim i mungesës së energjisë elektrike. Për sistemin e ngrohjes përdoren më shumë burimet drusore si dhe gazit dhe kondicionerët. Në qytetin e Bajram Currit rreth 95% e popullsisë ka sistem ngrohje individuale.

Telekomunikacioni u grupua me shërbimet postare dhe ato telegrafike nga viti 1990-1992. Në vitin 1992 shërbimi telefonik u nda nga shërbimi postar duke krijuar ndërmarrjen publike që u quajt "Albtelecom", si rezultat i kësaj shërbimet telefonike u permisuan jashtë mase, ku shumë familje u pajisën me një telefon

linjë të cilat mbuluan më sinjal telefonik të gjithë qytetin dhe zonat rurale. Aktualisht sot operojnë të gjitha kompanitë e telefonisë celulare si Vodafon, AMC, Eagle Mobile dhe Plus. Lidhur me telekomunikacionin është edhe çështja e shfrytëzimit të internetit. Interneti në Bajram Curri ofrohet nga kompania private si dhe Albrelecom-i. Kjo çoi dhe në hapjen e internet-kafeve, gjë e cila ka mundësi që çdo i rid he kushdo tjetër të ketë mundësinë e aksesimit në internet. Shumica e familjeve e kanë një linjë internet në familje. Gjithashtu internet shfrytëzohet dhe nëpërmjet celularëve.

Sherbimet postare operojnë në gjithë qytetin. Gjithashtu për shërbimet postare monetare ndodhet një Wester Union. Gjithashtu në qytetin e Bajram Currit janë dhe filialet e disa bankave private që operojnë në Shqipëri si Raifaissen Bank etj.

Infrastruktura rrugore është transporti kryesor. Qyteti lidhet me fshatrat me anë të fugonave të cilët transportojnë njerëz dhe mallra. Shërbimi i transportit që lidh qytetin me rrethet e tjera kryet çdo ditë me Kosovën, Tiranën, Durrësin, Hasin etj. Infrastruktura rrugore ka ardhur çdo vit në përmisim. Rruga nacionale Tiranë-Bajram Curri është asfaltuar dhe në gjendje të mirë. Gjithashtu vitet janë realizuar dhe projektet për përmisimin e rrugëve që lidhin qytetin me fshatrat siç është ajo e Bajram Curri-Valbonë. Disa nga rrugët e brendshme të qytetit janë rikonstruktuar siç janë rruga "Agim Ramadani", rruga "Beswlidhja e Malësisë", rruga "Mic Sokoli", etj. Gjithashtu janë në rikonstruktim e sipër rrugët "Partizani" dhe "Asim Vokshi".

Gjendja e mjedisit

Problemet kryesore mjedisore në qytetin e Bajram Currit janë mbetjet urbane, mbetjet inertedhe kanalizimi i ujrave të zeza. Organizimi i grumbullimit, transportimit, depozitimit dhe asgjësimit të mbetjeve urbane paraqet një numër vështirësish dhe një kosto të konsiderueshme financiare. Problemet kryesore me të cilat përballet ky sector janë:

- Sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe jo shumë efikase ;
- Mungon informacioni mbi sasinë dhe përbërjen e mbetjeve i cili do të ndihmonte në përcaktimin e alternativave më të përshtatshme teknike;
- Shërbimi i pastrimit, grumbullimit të mbetjeve dhe sistemet e menaxhimit nuk janë bashkëkohore
- Burimet financiare dhe teknike për këtë sector kanë qënë dhe vazhdojnë të jënë të pamjaftueshme;
- Mungon ndërgjegjësimi public rreth trajtimit të mbetjeve dhe rreth koston së dëmit që shkaktohet nga keqmenaxhimi, etj.

Përgjegjësia për grumbullimin e mbetjeve urbane i përket qeverisjeve lokale dhe përzgjedhja e firmave të duhura të sektorit privat për dhënien e këtij shërbimi është mjaft e rëndësishme. Organizmi aktual i pastrimit dhe heqjes së mbetjeve urbane vështirësohet nga kufizimet e mëposhtme:

- Standard i ulët i mjeteve transportuese ;
- Kushte të këqija të kontejnerëve për shkak të parregullsisë së heqjes së mbeturinave ;
- Kontejnerët nuk vendosen në vende të miratuara ;
- Mungon infrastruktura e nevojshme ;
- Ujërat që depërtojnë nëpër hapësirën e vend depozitimit të mbetjeve bëhen të ndotura ;
- Mjete të pamjaftueshme për menaxhimin e pandërprerë të mbetjeve ;
- Nuk monitorohet sasia e mbetjeve dhe ndikimi i tyre në mjedis;

Mbetjet urbane në qytetin e Bajram Currit kanë arrdhur duke u rritur nga viti në vit pasi kemi rritje të konsumit të popullsisë , ndërsa mbetjet inerte kanë një tendencë ulje. Kështu nëse i referohemi

statistikave të vitit 2010, popullsia ishte rreth 8159 banorë, sasia vjetore e mbetjeve ishte 0.716ton/banorë, nga të cilat 2500 ton janë mbetje urbane dhe 1300 ton janë mbetje inerte. Një nga problemet më shqetësuese për qytetin ka qënë vendgrumbullimi i mbeturinave në hyrje të qytetit.me financimin e buxhetit të shtetit është ndërtuar venddepozitimi (landfill) i ri i mbetjeve urbane në Koj. Ka filluar depozitimi i mbetjeve që nga viti 2010. Një tjetër problem për bashkinë është mungesa e kazanëve nga vetë spitali ku grumbullimi i mbetjeve bëhet në “ kutinë e mbetjeve spitalore” ku këto mbetje hidhen në këto kuti dhe digjen nga personat përkatës. Riciklimi i mbetjeve urbane në të gjithë vendin përgjithësisht nuk është efektiv. Në qytetin e Bajram Currit ai është thujse inekzistent me përjashtim të disa rasteve të shkëputura(mbledhja e hekurishteve dhe metaleve të papërdorshme nga njerëz të varfër). Ndryshimi i kësaj situatë do të kërkojë për shumë kohë, përpjekje ,investime dhe planifikim të mirë. Një tjetër problem mjedisor në qytetin e Bajram Currit janë edhe materialet e mbetjeve inerte, të cilat përmbajnë material të tjera të tilla si metale dhe bojëra. Me zhvillimin ekonomik dhe zgjerimin e industrisë së ndërtimit , këto lloj mbetjesh do të rriten ndjeshëm. Megjithëse bashkia ka aprovuar një vend për depozitimin e këtyre mbetjeve, përsi hedhja e tyre në vende të paautorizuara është e shpeshtë. Megjithëse iniciativa për përmisimin e gjëndjes së mjedisit në qytetin e Bajram Currit janë të kënaqshme, sërisht mbeten disa sfida për tu realizuar:

- Rehabilitimi i vend depozitimit të mbyllura (zbukurimi i tyre dhe mbjellja e pemëve);
- Heqja e mbetjeve të depozituara në vendet e paautorizuara ;
- Vendosja e sanksioneve për ndotësit ;
- Fushatë ndërgjegjësimi publik për mbetjet ;
- Puna bindëse në nivele të Këshillit Bashkiak që problemi i mbetjeve urbane duhet të përmirësohet si një çështje prioritare ;
- Miratimi i shesheve për “varrezë makinash” , etj.

Një tjetër problematikë mbetet dhe ndërgjegjësimi dhe sjellja e komunitetit lokal ndaj ambientit ku janë konstatuar disa problem si:

- Raste të djegies së gomave në natyrë dhe djegies së mbetjeve në kontejnerët e mbetjeve urbane ose pranë tyre ;
- Riciklimi i kanaqeve të aluminit dhe metaleve të tjera të tilla si hekur dhe bakër bëhet nga individë të cilët nuk janë të liçensuar dhe punojnë pa paisjet e duhura gjë e cila në disa raste ka shkaktuar problem shëndetsore ;
- Bizneset shpesh i hedhin mbetjet në mënyrë të pakontrolluar .

Rrisqet e mundshme

Shtrirja e qytetit në një rrafshinë në rrëzë të Alpeve, Bajram Curri ndoshet në kufi të një zone me rrezik shkëputjeje aktive, e cila është e vazhdueshme në drejtimin jugperëndim-verilindje. Kjo sjell që të ketë eurozion të shpeshtë , sidomos në kohë të reshjeve, të cilat arrijnë mbi 2000mm në vit. Veprimtaria e borës është gjithashtu e lartë dhe herë pas here shfaqet rreziku i orteqeve dhe ngricave.

5 - IDENTIFIKIMI DHE VLERSIMII NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT ZBUTESE PER MINIMIZIMIN E TYRE

5.1 Hyrje

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit te mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme te cilat mund te kene ndikim ne mjedis. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimet e mbrojtjes se mjedisit
- Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
- Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes se integruar
- Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit
- Parimi "Ndotsi paguan"
- Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrojtjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si vegmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

- Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:
- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujerave
- Mbrojtja e tokes
- Mbrojtja e natyres
- Ndryshimet klimatike

5.2. Menyra e menaxhimit te mbetjeve inerte qe gjenerohen nga ndertimi

Mbetjet inerte do te menaxhohen ne bashkepunim me perfaqesues te Njesise se Qeverisjes Vendore, bazuar edhe ne VKM Nr. 575, date 24.06.2015, "Per menaxhimin e mbetjeve inerte". Keto mbetje do te depozitohen ne nje zone te caktuar nga Bashkia. Nje pjese e ketyre mbetjeve do te sistemohen ne sheshin e ndertimit pas perfundimit te punimeve. Do te perdoret per mbushje te aneve te themeleve, per sistemimin e sheshit dhe siperfaqet e gjelberta.

Mbetjet e ngurta nga punimet e ndertimit do te jene ne sasi shume te vogel, duke qene se punimet do te jene te lehta dhe kemi te bejme me konstrukcion metalik.

5.3 Llojet e ndikimeve kryesore ne mjedis dhe vleresimi i tyre

5.3.1. Ndikimet kryesore ne mjedis

Nga ndertimi dhe funksionimi i nje aktiviteti konsistojne ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Shkarkimet ne uje
- Ndikimi ne toke
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e prodhuara

- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones
- Ndikim ne ndryshimet klimatike

Vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi, eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme, te asaj veprimtarie ne mjedis. Gjate procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, te referuar ne paragrafin e mesiper, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjellta.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit. Ne baze te ketij vleresimi, institucioni pergjegjes per mjedisin, merr ne shqyrtim dhe kryen verifikimet perkatese per lejimin ose jo te zhvillimit te nje aktiviteti te caktuar. Institucioni pergjegjes per shqyrtimin e dokumentacionit dhe aprovimin ose jo te lejes mjedisore para vendimarrjes se tij, konsultohet edhe me institucione te tjera te cilat kane lidhe te drejteperdrejte ose jo te drejtperdrejte me projektin ose ndikohen nga ky i fundit. Konsultimi eshte edhe me i gjere me publikun e ndikuar dhe palet e interesit.

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis:

- Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte: Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te kantierit te ndertimit, gazet e mjeteve te ndertimit dhe te transportit.
- Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut nga kantieri dhe ujerat e zeza nga aktiviteti gjate shfrytezimit te kompleksit.
- Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu qe do te largohet nga siperfaqja qe do te ndertohet.
- Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, nga transporti, por edhe gjate funksionimit nga aktivitetet me muzike ne oret e vona, nese do te zhvillohen.

5.3.2. Kohezgjatja e ndikimeve ne mjedisin e zones

Ndikimet kryesore do te jene gjate zbatimit te punimeve ndertimore, qe do te zgjasin rreth 300 dite.

- Siperfaqja e shtrirjes se ndikimit ne mjedis

Ndikimi ne mjedis do te jete vetem per zonen perreth kantierit te ndertimit, kjo deri ne nje perimter rreth 200m rreth kantierit.

- Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe kthimi i mjedisit ne gjendjen e meparshme.

Pas perfundimit te punimeve ndertimore, do te behet pastrimi dhe largimi i mbetjeve inerte qe mund te kene ngelur, gjelberimi qe eshte pjese e projektit, por nuk mun te pretendojme rikthim ne gjendjen e mepareshme te tokes, pasi kjo qender eshte projektuar per nje peridhe shume te gjate kohore.

5.3.3 Vleresimi i ndikimeve ne mjedis

***Ndikimet ne popullsi**

Vendi ku zhvillohet aktiviteti, ndodhet larg zonave te banuara, objekti nuk sjell shqetesime per banoret. Nga ngritja e aktivitetit nuk ka shpronesime dhe zhvendosje te popullsisë.

***Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

***Ndikime ne flore e faune**

Objekti ze nje siperfaqe te vogel. Si u pa edhe ne fot, enkas eshte zgjedhur nje siperfaqe e zhveshur dhe nuk parashikohet prerja e ndonje peme. Gjithesesi ne cfaredo rasti, do te behet kerkese per heqje nga fondi pyjor apo kullosor. Nga ky aktivitet nuk do te vijne shqetesime si humbje te bimesise, prishje habitatesh, ekosistemesh etj.

***Ndikimet ne uje**

Duke qene se ndertimi i objektit ka ndikim vetem gjate fazes se ndertimit (maksimumi 90 dite) nuk ka shkarkime ne uje. Sic u tha me lart, do te behet terheqja e mbetjeve inerte sipas VKM ne fuqi. Po keshtu edhe per burimet nentokesore ky aktivitet nuk perben rrezik, pasi ky aktivitet nuk kerkon perdorim uji.

***Ndikimet ne toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi humbje te tokes, rreshkitje te dherave, erosion etj. Asnje lloj mbetjeje nuk do shkarkohet ne toke. Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i pergjithshem i personelit apo ato te tipit ambalazh, shkon ne vendet e caktuara nga pushteti lokal.

***Ndikimet ne ajer**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk do te kemi emetime te gazeve te demshem apo te ererave te renda ne mjedisin perreth.

6 - PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

6.1. Plani i Monitorimit Social e Mjedisor gjate ndertimit e funksionimit

Ceshtja	Masat	Pergjegjesia	Periudha
Pluhuri	Eshte e nevojshme qe konsulenti te kryeje vezhgime vizuale te ngritjes se pluhurit gjate gjithe fazes ndertimore. Te gjitha aktivitetet, para fillimit te tyre, duhet t'i nenshtrohen nje vleresimi per mundesine e ngritjes se pluhurit. eshte me rendesi vezhgimi i kushteve te motit.	Kontraktori/ Investitori	Gjate gjithe fazes se ndertimit
Komunikimi	Hapja dhe perditesimi i nje regjistri per regjistrimin e te gjitha komunikimeve lidhur me ceshtjet mjedisore dhe sociale, perfshire ankesat. Kjo do te arrihet nepermjet mekanizmit ekzistues te mbledhjes se ankesave.	Kontraktori/ Investitori	Gjate gjithe fazes se ndertimit
Mbetjet	Inspektime vizuale te zonave te ruajtjes, grumbullimit dhe largimit te mbeturinave. Regjistrimet te behen ne baze te inspektimeve.	Kontraktori/ Investitori	Inspektime mujore. Marrja e masave parandaluese dhe korrigjuese, ne se eshte e nevojshme
Mbetjet e lengshme	Sigurimi se mbetjet jane menaxhuar ne menyren e duhur, bazuar ne kuadrin ligjor per kete qellim.	Kontraktori/ Investitori	Vazhdimisht gjate funksionimit te aktivitetit
Ekologjia Tokesore	Brez pemesh per te siguruar ndarjen Program edukativ mbi mjedisin. Monitorimi i levizjes se kafsheve ne rruget e hyrjes ne zone	Kontraktori/ Investitori	Gjate ndertimit dhe funksionimit te Kompleksit

Ekologjia ujore	Monitorimi i ujerave qe do te shkarkoje ne mjedis ky aktivitet. Monitorimi i objekteve te largimit te mbetjeve te ngurta e te lengshme ne toke	Kontraktori/ Investitori	Gjate ndertimit dhe funksionimit te Kompleksit
Social- Ekonomike: Cilesia e jetes se punetoreve ndertimit*	Pyetesor drejtuar punetoreve, vizita terrene Ky pyetesor e do te realizohet nga nje specialist, i trajnuar e me pervojete ne standardet dhe ceshtjes e punes.	Kontraktori/ Investitori	Gjate ndertimit dhe funksionimit te Kompleksit
Social- Ekonomike: Monitorimi aspekteve shendetesore	Identifikimi i treguesve dhe sigurimi i statistikave te shendetit te punetoreve	Doktori pergjegjes per punonjesit	Cdo muaj
Monitorim vazhdueshem parametrave mjedisore (Clirimet ne uje dhe ne toke]	Pajisjet e monitorimit dhe metodat do te jene ne perputhje me kerkesat kombetare shqiptare per kete aktivitet sipas VKM Nr. 1189, date 18.11.2009 "Per monitorimet" dhe ne kushtet e vena ne lejen mjedisore.	Investitori	Gjate gjithe fazes se ndertimit.

7. PROGRAMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE MONITORIMI I TREGUESVE TE MJEDISIT

Plani i Menaxhimit Mjedisor

Ky seksion perfshin pershkrimin e Planit te Menaxhimit Mjedisor (PMM) e projektit. Qellimi kryesor i PMM te siguroj ne proces te drejt gjate projektimit, ndertimit dhe operimit ne terma te impaktit dhe masave parandaluese te vleresuara ne Seksionin nr.6

PMM dhe Programi i Monitorimit Mjedisor do te jete ne formen e nje drafti ne menyre qe te siguroj implementimin e rekomandimeve parandaluese dhe te parandaloj te ndonje ndikimi te mundshme mjedisor te anashkaluar ne raportin e VNM-se

Pavaresisht nga kjo, PMM stimulon procedurat dhe rregullat qe duhet te ndiqen gjate ndertimit dhe per me shume gjate operimit te ketyre antenave. Plani i menaxhimit vleresohet ne tre faza kryesore.

Fazen e projektimit

Gjate kesaj faze eshte e rendesishme identifikimi i pronareve, faze kjo tashme e perfunduar ku te gjithe pronaret jane identifikuar dhe jane lidhur kontratat. Si dhe nje prej ideve kryesore eshte te shmanget konflikti midis mjedisit natyror dhe menaxhimit te tokes, ku dhe ky proces jane tashme te perfunduar me identifikimin e cdo site dhe realizimi i planimetricimeve perkatese per keto site.

Fazen e ndertimit

Punimet e ndertimit per cdo site do te zbatohen nen mbikeqyrjen e supervizorit te percaktuar nga kontraktori.

Per te shmangur demtime apo nderhyrje ne zona te mbrojtura si trashegimi kulturore eshte e rendesishme qe te konsultohet me Institutin e Monumenteve te Kultures per te identifikuar zbulimet e raja qe nuk jane hedhur ne listen e zonave te trashegimise kulturore.

Plani i punes dhe i punimeve do te ndermeret nga kontraktori para se te filloj ne terren punimet specifike, bazuar ne kapacitetin e kontraktorit (numri i punonjesve, numri dhe cilesia e mjeteve dhe mekanizmave qe disponojne per kete proces). Punimet e ndertimit duhet te sistemohen dhe programohen ne menyre te tille qe te minimizojne ndikimin mbi mjedis.

8. REKOMANDIME

- Te kryhet menaxhim i integruar i mbetjeve te ngurta duke i seleksionuar dhe menaxhuar nepermjet kontratave kontraktuale me Njesine e Qeverisjes Vendore ose subjekte te licensuar per kete qellim.
- Te mos hidhet asnje mbetje e ngurte ose e lenget ne mjedisin uhor dhe ate tokesor te zones.
- Te kryhet monitorimi i treguesve mjedisor dhe raporti periodik i vetemonitorimit dhe te dorezohet ne DRM per periudhen e punimeve te ndertimit.
- Mirembajta dhe gjelberimi ne menyre te vazhduesheme i mjediseve perreth objekteve duke ruajtur nje imazh te kendshem dhe per rritjen e vlerave te rekreacionit te ketyre objekteve.
- Te rehabilitohet mjedisi i zones, duke mbjelle bime te larta ne perimetrin e kompleksit per te reduktuar impaktin vizual te kompleksit.
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe te ndryshimeve te tij

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 353 Rep

V E R T E T I M

Sot, ne Tirane, me date 25.02.2017 para meje noteres Ilirjana Çela, me studio ne Tirane, u paraqit personalisht shtetasi :

Fatjona LEVANI, atesia Barjam, lindur ne Fier, me 26.10.1982, banuese ne Tirane, madhore me zotesi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me dokumentin e Pasaporte nr BI 2076217 nr personal I 26026050 D, e cila kerkoj vertetimin e fotokopjes se dokumentit original qe eshte: **License QKB kodi III.2A (1+2) date 25.11.2016** dhe pasi konstatova se dokumenti nuk ka korrigjim, shtesa, fshirje, ne baze te ligjit Nr. 7829 dt. 01.06.1994 "Per Noterine" dhe Udhezimit te M.D. Nr. 6291 dt. 17.08.2005, vertetoj se:

"Vertetohet se njesia eshte kopje e njejte me dokumentin original"



NOTERE
Ilirjana ÇELA






REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

LICENCË

Numri serial: LN-2370-11-2016
NUIS/NIPT: L62318015G



Subjekti: Ira Dafa

Adresa: Tirane, Tirane, Tirane, Rruga "Vangjush Furxhi", Pallati 14,
Shkalla 12, Ap.2, Kati 1

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 25/11/2016

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënskrimi i sportelit:

Ky dokument mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprerjet detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 7183 Prot.

Tiranë, më 8 / 10 2012

Nr. identifikues 44

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Znj. IRA DAFA


Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDBU







REPUBLIKA E SHqipërisë
 MINISTERIA E ZHVILLIMIT
 EKONOMIK, TREGTISE
 DHE SIPERMARRJES

OKB

Qendra Kombëtare e Biznesit
 National Business Center

NUMRI SERIAL:
 SN-442966-11-16



ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të tatueshëm:

Ira Dafa – Person Fizik

Statusi:

Aktiv

Me adresë kryesore:

Tirane, Tirane, Rruga "Vangjush Furxhi", Pallati 14, Shkalla 12, Ap.2, Kati 1

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):

L62318015G

Afati i veprimtarisë:

Nga: deri

DATA E REGJISTRIMIT

18/11/2016

DATA E LËSHIMIT

18-11-2016

SPORTELI I SHËRBIMIT:

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

(Signature)

(Emri, Mbiemri) i nëpunësit të sportelit

Ky dokument mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në qendrën e regjistrimit dhe të ruhet në arkivin e qendrës së regjistrimit për të qenë person i tatueshëm.





EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "PERSON FIZIK"

GJENDJA E REGJISTRIMIT FILLESTAR

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L62318015G
2. Emri i subjektit	Ira Dafa
3. Forma ligjore	Person Fizik
4. Data e regjistrimit	18/11/2016
5. Fusha e veprimtarisë	Vlersim i pasurive te paluajtshme. Vleresimi i ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor. Projektim dhe punime topografike. Agjenci imobiliare.
6. Vendi i ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Vangjush Furxhi", Pallati 14, Shkalla 12, Ap.2, Kati 1
7. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
8. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Telefon: 0692023033
9. Statusi	Aktiv

Lista e Dokumenteve:

Aplikim per regjistrimin fillestar te personit fizik

Regjistrimi Fillestar: CN-039481-11-16

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
---------------------	--

Datë: 18/11/2016


Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

